

**PËRMIRËSIMI I ROLIT TË KUVENDIT NË LIGJBËRJEN DHE
MBIKQYRJEN E MEDIAS NË SHQIPËRI
(DOKUMENT PUNE)**

Nëntor, 2023

Të gjitha të drejtat për këtë dokument, përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD) dhe mbrohen nga ligjet e zbatueshme të Mbretërisë së Bashkuar dhe ato ndërkombëtare. Ky dokument nuk mund të kopjohet, ndahet, përkthehet në një gjuhë tjetër, apo të përshtatet pa leje paraprake nga WFD.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj, nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin që mund t'i jetë bërë informacionit që ai përmban.

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PERMBAJTJES	3
LISTA E SHKURTIMEVE	4
PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
I. HYRJE	6
II. QASJE TEORIKE MBI ROLIN LIGJBËRËS DHE MBIKQYRËS TË KUVENDIT	7
III. METODOLOGJIA	8
IV. ANALIZA E LEGJISLACIONIT PRIMAR DHE SEKONDAR NË FUSHËN E MEDIAVE.....	11
V. ANALIZA E KUADRIT INSTITUCIONAL NË SHQIPËRI NË FUSHËN E MEDIAVE .	15
VI. GJETJET NGA INTERVISTAT E THELLUARA.....	17
VII. HAPËSIRAT PËR RREZIK KORRUPSIONI DHE PËRMIRËSIMI I ROLIT LIGJBËRËS DHE MBIKËQYRËS TË KUVENDIT NË SEKTORIN E MEDIAS NË SHQIPËRI	22
VIII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	27
REFERENCAT.....	29

LISTA E SHKURTIMEVE

AMA- Autoriteti i Mbikqyrjes Audiovizive

RTSH- Radio Televizioni Shqiptar

KDRTSH- Këshilli Drejtues i Radio Televizionit Shqiptar

RIA- Regulatory Impact Assessment

OSHMA- Ofrues i shërbimeve mediatike audiovizive

KDIMDP- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

GDPR- Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mjedisi mediatik në Shqipëri karakterizohet nga përplasje e interesave të sektorit privat dhe politikës, mungesa e transparencës së burimeve financiare, si dhe koncentrimi i pronësisë së mediave. Këto faktorë, së bashku me frikën dhe kushtet e vështira të punës, kanë ndikuar në kufizimin e lirisë së gazetarisë dhe kualitetin e informacionit të ofruar. Për të përmirësuar këtë situatë, nevojitet një kuadër ligjor që mund të adresojë sfidat dhe do të promovojnë pavarësinë e mediave, pluralizmin dhe cilësinë e gazetarisë. Gjithashtu, roli mbikqyrës i Kuvendit është kritik në zbatimin efektiv të këtij kuadri ligjor.

Nga shqyrtimi i kërkimeve ekzistuese, analizës së kuadrit ligjor dhe intervistave të thelluara, si më poshtë prezantohen gjetjet kryesore dhe disa hapësira për përmirësime në të ardhmen, me qëllim përmirësimin e transparencës dhe fuqizimin e rolit të Kuvendit në sektorin e medias në Shqipëri.

- Legjislacioni në fushën e lirisë së shprehjes, së drejtës për informim dhe të drejtave të gazetarëve duket i plotë, por konstatohet herë pas here moszbatim i tij, që çon në cënim të këtyre lirive dhe të të drejtave;
- Gazetarët janë të censuruar nga pronarët e mediave, pasi këto të fundit kanë lidhje të ngushta dhe okulte me qeverinë, pushtetin ekonomik apo qarqe të tjera të interesave të krimit;
- Të drejtat e gazetarëve në fushën e punësimit vijnë të jenë të pazbatuara, ende ka gazetarë që punojnë pa kontrata pune, ose me kontrata me periudha prove për t'i mbajtur nën presion, ose janë të paguar ligjërisht me paga minimale dhe përfitojnë shpërblime shtesë me pagesa cash;

Mbështetur në gjetjet e mësipërme dhe të tjera të elaboruara në brendi të dokumentit, ky dokument pune vjen me disa rekomandime të listuara sa më poshtë:

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të ndërmarrë nisma të rishikimit të legjislacionit në fuqi, për t'i paraprirë evoluimit të profesionit të gazetarit, duke përcaktuar ligjërisht statusin e gazetarit, incentiva për vetëorganizimin e këtij profesioni të lirë, si dhe për mbështetjen nga Shteti të shoqatave dhe të sindikatave të gazetarëve;
- Të realizohet transparencë e plotë e strukturës së pronësisë, përfshirë pronarët përfitues të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA);
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të bëjë transparente çdo nismë ligjore, që është e depozituar dhe përfshirë në programin e punës të miratuar dhe nismat ligjore të depozituara në Kuvend të shqyrtohen dhe t'i nënshtrohen vendimmarrjes brenda vitit të depozitimit të tyre.

I. HYRJE

Në këtë dokument, do të diskutohet rëndësia e përmirësimit të rolit të Kuvendit në ligjbërjen dhe mbikëqyrjen e sektorit të medias në Shqipëri dhe do të propozohen masat dhe rekomandimet për të arritur këtë qëllim. Kuvendi është institucioni kryesor për përfaqësimin e vullnetit të popullit në Shqipëri dhe është një nga organet kryesore të qeverisjes demokratike të vendit.

Sipas organizatave vendase dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave, mjedisi mediatik shqiptar ka degraduar në vitet e fundit, nën një qeverisje që ka kufizuar gjithnjë e më shumë qasjen e gazetarëve dhe ka kërkuar miratimin e ligjeve që nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe praktikave më të mira.¹ Ndër më të rëndësishmit, raporti vjetor i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2023 thekson se "...ndërthurra e interesave të biznesit dhe politikës, mungesa e transparencës së burimeve të financimit, përqëndrimi i pronësisë së medias, kërcënimet dhe kushtet e pasigurta të punës vazhduan të pengojnë pavarësinë e medias, pluralizmin dhe cilësinë e gazetarisë. Atmosfera e sulmeve verbale dhe fizike, fushatat e shpifjeve dhe paditë për frikësim kundër gazetarëve, nuk janë përmirësuar²". Në këtë kuadër, roli ligjbërës dhe mbikqyrës i Kuvendit bëhet akoma më kritik.

Në këtë dokument pune, do të analizohet roli aktual i ligjbërjes dhe mbikqyrjes së Kuvendit në Shqipëri dhe do të propozohen disa rekomandime për përmirësimin e këtij roli, me fokus kryesor sektorin e medias në Shqipëri. Ky dokument synon të jetë një kontribut i vlefshëm në diskutimet aktuale rreth ndryshimeve ligjore mbi sektorin e medias në Shqipëri.

¹ <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2020/08/Internet-Governance-1-1.pdf>

² Raporti Shqipëria 2023, Komisioni Europian (SWD(2023) 690 final), fq 31. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

II. QASJE TEORIKE MBI ROLIN LIGJBËRËS DHE MBIQYRËS TË KUVENDIT

Për të analizuar rolin e Kuvendit në Republikën e Shqipërisë duhet t'i referohemi Kushtetutës³, në të cilën parashikohet, në nenin 1, pika 1, të saj: *“Shqipëria është republikë parlamentare”*. Në nenin 2, pika 2, të Kushtetutës se: *“Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti”*, si dhe në nenin 7 të saj parashikohet shprehimisht se: *“Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.”* Këto parashikime kushtetuese e kornizojnë llojin e sistemit parlamentar që ne kemi e për rrjedhojë edhe rolin e Kuvendit si ushtrues i pushtetit legjislativ në vend.

Kuvendi mund të ushtrojë rolin e tij mbikëqyrës në disa forma të ndryshme, përfshirë:

- **Pyetjet, interpelancat dhe mocionet⁴**

Të gjithë deputetët kanë të drejtën t'i paraqesin pyetje Kryeministrit ose çdo anëtar tjetër të Këshillit të Ministrave. Pyetjet paraqiten nga deputetët tek Kryetari i Kuvendit, i cili informon anëtarin e Këshillit të Ministrave, të cilët i drejtohen pyetjet. Pyetjet bëhen me qëllim për të marrë informacion lidhur me një ose disa çështje të caktuara. Pyetjet duhet të jenë të shkruara në një mënyrë të qartë dhe të përmbledhur dhe të përmbajnë çështje që ndodhen brenda kompetencave të personave që pyetjet drejtohen, ose në lidhje me veprimtarinë administrative për të cilën po kërkojnë përgjigje.

- **Kontroli nga komisionet e përhershme të Kuvendit⁵**

Komisionet e përhershme të Kuvendit mund të paraqesin raporte ose propozime për çështje nën kompetencën e tyre ose kur iu kërkohet nga Kuvendi. Ata gjithashtu kanë të drejtë të kryejnë kontrole dhe të kërkojnë dokumentacion për të analizuar një çështje të veçantë brenda fushave të tyre të përgjegjësisë.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik- Është një nga komisionet e përhershme parlamentare, që ka për kompetencë të shqyrtojë brenda fushave të përgjegjësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, të kryejë studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, të ndjekë zbatimin e ligjeve dhe të kontrollojë veprimtarinë e ministrive dhe të organeve të tjera qendrore, duke i propozuar Kuvendit ose Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse, si dhe ka të drejtë të propozojë për miratim në Kuvend projektligje, projektdeklarata ose projektrezoluta. Fushat e përgjegjësisë së këtij komisioni janë: arsimit në çdo nivel, kultura, rinia,

³ E miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21. 10. 1998, i ndryshuar;

⁴ PJESA E TRETË, KONTROLLI I KUVENDIT KREU I, PYETJET, INTERPELANCAT DHE MOCIONET. RREGULLORJA E KUVENDIT.

⁵ Neni 102, Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

shkenca, sportet, **media e shkruar dhe vizive**, si dhe çështjet e agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe zbatimi i angazhimeve, që rrjedhin prej saj.

- **Raportimi në Kuvend⁶**

Kryetari i Kuvendit, nëpërmjet Konferencës së Kryetarëve, vendos në fillim të çdo viti për kalendarin e paraqitjes së raporteve të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj në Kuvend. Ky kalendar përfshin organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj që do të paraqesin raportet, si dhe komisionin përgjegjës për shqyrtimin e tyre dhe afatin ligjor për depozitimin në Kuvend. Kuvendi i kërkon zyrtarisht institucioneve të përcaktuara dorëzimin e raporteve brenda afatit ligjor në Kuvend. Kalendari i paraqitjes së raporteve bëhet i njohur në seancën plenare të parë, publikohet dhe shpërndahet institucioneve përkatëse.

III. METODOLOGJIA

Për të realizuar këtë punim, janë përdorur metodat e mëposhtme të grumbullimit të informacionit.

3.1 Analiza e studimeve ekzistuese

ACER ka realizuar një kërkim të thelluar të dokumenteve kërkimorë të zhvilluar nga organizata kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me problematikat e sektorit të medias në Shqipëri. Përveç raporteve, ACER ka bërë një kërkim të thelluar të legjislacionit aktual mbi lirinë e medias në Shqipëri për të arritur në gjetje solide mbi kritikën e kuadrit ekzistues ligjor. Gjetjet kryesore të kërkimit sekondar, gjenden në seksionet e mëposhtme.

3.2 Intervista të thelluara

Për të ndërtuar një pamje të qartë të problematikave dhe hapësirave të cilat kërkojnë ndërhyrje, ACER ka kontaktuar aktorë të rëndësishëm të sektorit të medias në Shqipëri. Për këtë, është ndërtuar fillimisht një listë pyetjesh dhe janë realizuar intervista të thelluara. Këto intervista kanë ofruar informacione të rëndësishme, lidhur me mjedisin aspak mbështetës mediatic në Shqipëri, duke sugjeruar edhe ndërhyrje të nevojshme për të përmirësuar situatën. Gjetjet kryesore të intervistave të thelluara, gjenden në seksionet e mëposhtme.

⁶ Neni 100, Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

IV. MJEDISI MEDIATIK NË SHQIPËRI

Përplasja e interesave me natyrë politike dhe të biznesit, mungesa e transparencës së burimeve të financimit, koncentrimi i pronësisë së mediave, frika dhe kushtet e padëshirueshme të punës vazhduan të pengojnë pavarësinë e mediave, pluralizmin dhe cilësinë e gazetarisë.⁷ Kjo situatë tregon një ambient të vështirë për mediat në Shqipëri, ku ndikimi i interesave politike dhe të biznesit shpesh çon në kufizime të lirisë së gazetarisë. Mungesa e transparencës rreth burimeve të financimit sjell shqetësime rreth integritetit të lajmeve dhe analizave të pavarura. Përveç kësaj, klima e intimidimit dhe kushtet e padëshirueshme të punës për gazetarët dhe profesionistët e medias shkaktojnë sfida të mëdha në sigurimin e një mjedisi të lirë dhe të sigurt për gazetarinë. Është e rëndësishme që të zhvillohen masa dhe politika të reja që do të adresojnë këto sfida dhe do të promovojnë pavarësinë e mediave, pluralizmin dhe cilësinë e gazetarisë në Shqipëri.

Edhe pse i ndryshuar, mjedisi mediatik karakterizohet nga probleme sistematike, përfshirë pronësinë e koncentruar të mediave dhe kontrollin e ushtruar nga interesat e lidhura midis biznesit dhe politikës, të cilat ndikojnë në lirinë e mediave. Ky mjedis, në kombinim me rregullat për mbulimin e mediave të zgjedhjeve, favorizon partitë kryesore.

Sipas organizatave vendase dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave, mjedisi mediatik shqiptar ka degraduar në vitet e fundit, nën një qeverisje që ka kufizuar gjithnjë e më shumë qasjen e gazetarëve dhe ka kërkuar miratimin e ligjeve që nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe praktikave më të mira.⁸ Ndër më të rëndësishmit, raporti vjetor i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2023 thekson se: "...ndërthurja e interesave të biznesit dhe politikës, mungesa e transparencës së burimeve të financimit, përqëndrimi i pronësisë së medias, kërcënimet dhe kushtet e pasigurta të punës vazhduan të pengojnë pavarësinë e medias, pluralizmin dhe cilësinë e gazetarisë. Atmosfera e sulmeve verbale dhe fizike, fushatat e shpifjeve dhe paditë për frikësim kundër gazetarëve, nuk janë përmirësuar⁹".

Ndër të tjera, raporti përmend një sërë problemesh që lidhen me lirinë e mediave në vend, duke përfshirë kufizimet e diktuar në raste të veçanta, nevojën e fuqizimit të të drejtave mbi aksesin në informacionin publik, emërimeve politike në poste drejtuese të institucioneve publike apo lidhjeve mes politikës, biznesit dhe mediave në Shqipëri. Raporti thekson se: "...duhet të sigurohet akses i drejtpërdrejtë dhe transparent i mediave në institucionet qeveritare dhe aktivitetet e tyre, si dhe informacionin faktik jopartiak publik. Praktikave të shpërndarjes së materialeve audio, video dhe tekstit të parapërgatitur për media nga institucionet, zyrtarët publikë dhe partitë politike, veçanërisht në kuadër të zgjedhjeve, mbetet një fushë shqetësuese që duhet trajtuar¹⁰".

⁷ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

⁹ Raporti Shqipëria 2023, Komisioni Europian (SWD(2023) 690 final), fq 31. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

¹⁰ Idem, fq. 33

Raporti i Komisionit European për vitin 2023 rradhit dhe rekomandimet kryesore drejt të cilave duhet punuar për të përmirësuar lirinë e të shprehurit dhe mediave në vend:

- sigurimi i tolerancës zero ndaj frikësimit dhe ndjekje efektive gjyqësore në rastet e sulmeve kundër gazetarëve, duke përfshirë edhe dekriminalizimin e plotë të shpifjes;
- trajtimi i përqendrimit të lartë në pronësinë e medias dhe rritja ndjeshëm e transparencës mbi financimin e medias, duke përfshirë rishikimin e kërkesave ligjore për reklamën publike, në përputhje me standardet evropiane;
- përmirësimi i kushteve të punës për gazetarët, në veçanti duke forcuar mbrojtjen e punësimit dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë dhe zbatimin konsistent të kodit të punës.

Me një këndvështrim të ngjashëm, por nga një perspektivë më pranë fushës së lirisë së mediave, edhe raportet e organizatave të tjera ndërkombëtare, pasqyrojnë të njëjtën problematikë me lirinë e mediave në Shqipëri. Reporterët pa Kufij, në indeksin e lirisë së mediave 2023, e rendisin Shqipërinë në vendin e 96-të¹¹ nga 180 vende të përfshira në raport (me përmirësim të lehtë nga viti i mëparshëm), një pozitë kjo më e dobët në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2023. Raporti thekson se në Shqipëri, pavarësia editoriale kërcënohet nga rregullimet e politizuara dhe se gazetarët janë viktimë të krimit të organizuar e nganjëherë, të dhunës policore, të nxitur nga dështimi i qeverisë për t'i mbrojtur ata.

Konteksti ekonomik dhe ai politik në vend rezultojnë si më problematikët ndër komponentët e indeksit të lirisë së mediave 2023 të këtij raporti¹². Në të theksohet se fakti se pronësia e pjesës më të madhe të mediave shqiptare është e përqëndruar në duart e vetëm katër ose pesë kompanive ndërkohë që financimi publik përfaqëson një burim të madh të ardhurash për median, por shpërndarja e tij kryhet në mënyrë jo transparente dhe diskriminuese, që ngre pikëpyetje mbi ndikimin mbi media. Sipas raportit, në Shqipëri gazetarët janë nën presion politik që u përkeqësua në vitin 2021 nga përpjekjet për të kontrolluar informacionin gjatë zgjedhjeve parlamentare dhe pandemisë Covid-19. Politikanët kufizojnë pavarësinë editoriale me anë të rregullatorëve të medias shumë të politizuara dhe duke emëruar ata që janë përgjegjës për administrimin e medias publike. Duke ju referuar ngritjes së fundmi të Agjencisë për Media dhe Informim, raporti thekson se: "...një centralizim i kohëve të fundit i komunikimit të qeverisë mund të rezultojë në kufizime të mëtejshme për aksesin në informacionin e mbajtur nga shteti".

Raporti i Freedom House për vitin 2023 e rendit Shqipërinë me 67 pikë nga 100 të mundshme¹³, duke e klasifikuar atë si pjesërisht të lirë. Në pjesën mbi lirinë e mediave, raporti 2023 për Shqipërinë tregon se ndërsa Kushtetuta garanton lirinë e shprehjes, ndërthurja e interesave të fuqishme të biznesit, politikës dhe medias pengon zhvillimin e mediave të pavarura ku shumica shihen si të njëanshëm ndaj Partisë Socialiste ose Partisë Demokratike. Gazetarët kanë pak siguri në punë, paga të ulëta dhe mbeten subjekt i padive, kërcënimeve dhe sulmeve të herëpashershme fizike nga ata që përballen me kontrollin e mediave. Raporti i referohet misionit faktmbledhës të Këshillit të Evropës (2022) që paralajmëroi se mjedisi mediatik shqiptar po përkeqësohej pjesërisht për shkak të përqendrimit të sektorit mediatik. Misioni shprehu gjithashtu shqetësime për pavarësinë e rregullatorit të medias në vend, Autoritetit të Mediave Audiovizive.

¹¹ <https://rsf.org/en/country/albania>

¹² Idem

¹³ <https://freedomhouse.org/country/albania>

Prezenca e OSBE në Shqipëri mbështet dhe monitoron lirinë e medias në vend duke kontribuar në zhvillimin e medias përmes përmirësimit të standardeve profesionale dhe sigurimit të kuadrit ligjor në përputhje me parimet e OSBE-së. Aktivitetet e Prezencës së OSBE synojnë të bëjnë bashkë përfaqësuesit e mediave shqiptare për të njëjtat rregulla universale, duke inkurajuar transparencën, të drejtën e lirisë së informacionit dhe opinionit, duke mbështetur sigurinë e gazetarëve, me theks tek gazetarët femra. Së fundmi, gjatë muajit tetor 2023¹⁴, Prezenca e OSBE në Shqipëri organizoi Forumin e 8-të të përvitshëm mbi Zhvillimin e Mediave, që u fokusua në lirinë e shtypit dhe zhvillimin e medias në vend, sigurinë e gazetarëve dhe sfidat e dezinformimit dhe propagandës me të cilat përballen mediat dhe gazetarët në Shqipëri.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit publikon rregullisht Barometrin Kombëtar të Lirisë së Medias në Shqipëri, i cili hartohet në kuadër të një projekti që mbështetet nga Ambasada Britanike në Tiranë. Raporti më i fundit i vitit 2022 (referuar gjendjes në 2021), konfirmon gjendjen jo të mirë të medias dhe lirisë së shprehjes në vend duke evidentuar se situata vijon të mbetet problematike si përsa i përket lirisë së medias ashtu edhe kushteve të punës me të cilat përballen punonjësit e medias në Shqipëri. Të dhënat e raportit tregojnë se faktori më ndikues në çënimin e lirisë së mediave në Shqipëri rezulton ndërhyrja e qeverisë apo partive politike, e konfirmuar nga 83% e të anketuarve¹⁵.

IV. ANALIZA E LEGJISLACIONIT PRIMAR DHE SEKONDAR NË FUSHËN E MEDIAVE

Kuadri ligjor në Republikën e Shqipërisë në lidhje me lirinë e shprehjes, të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale ka një trajtim të gjerë, që nga Kushtetuta dhe më pas në ligjet e posaçme në zbatim të saj.

- **Kushtetuta¹⁶ e Republikës së Shqipërisë** në nenet 22, 23 dhe 35 rregullon lirinë e shprehjes, të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe kushtet në të cilat ato mund të mblidhen, përdoren dhe bëhen publike.

Neni 22

1. Liria e shprehjes është e garantuar.
2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.
3. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.
4. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.

Neni 23

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Neni 35

¹⁴ <https://www.osce.org/presence-in-albania/media-freedom-and-development>

¹⁵ https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi_Tetor-2022-KShH.pdf

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998.

1. Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij.
2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.
3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.
4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.

Kuadri kushtetues garanton si lirinë e shprehjes dhe atë të informimit. Në këtë kuptim e drejta e informimit në parim ka qenë e limituar vetëm me mbrojtjen e të dhënave personale, të sekretit shtetëror, si dhe të sekretit tregtar. Gjithësesi Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në këto dispozita është lejuese dhe me kufizime të vogla në ushtrimin e këtyre të drejtave.

Ligji¹⁷ nr. 97/ 2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”- Ky ligj rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike dhe zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre.

Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar.

(I) Transmetimet audiovizive zhvillohen mbi bazën e këtyre parimeve:

- a) veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë;
- b) veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve;
- c) veprimtaria e transmetimeve audiovizive nuk lejohet të cenojë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin kombëtar;
- ç) veprimtaria e transmetimeve audiovizive siguron informim objektiv dhe të paanshëm të publikut, duke paraqitur në mënyrë të saktë faktet dhe ngjarjet, si dhe duke respektuar formimin e lirë të opinionit;
- d) veprimtaria e transmetimeve audiovizive garanton të drejtën e çdo shtetasi për të marrë shërbime të transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të ofruara për publikun nga operatorët e shërbimeve audiovizive, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen edhe nga këto parime:

- a) garantimi i lirisë së shprehjes;
- b) garantimi i së drejtës së informimit;
- c) ruajtja e sekretit të burimeve të informacionit;
- ç) respektimi dhe garantimi i së drejtës së ruajtjes së jetës private.
- d) moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve;
- dh) moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën;
- e) garantimi i së drejtës së përgjigjes;
- ë) garantimi i së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të;

¹⁷ Ky ligj është përafuar plotësisht me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për Shërbimin Mediatik me Zë dhe Figurë, versioni i kodifikuar), Numri CELEX: 32010L0013, Fletore Zyrtare e BE-së, Seria L 95, datë 15. 4. 2010.

f) respektimi i fqinjësisë së mirë midis popujve.

Për zbatimin e këtij ligji, si për licencimin, kontrollin e subjekteve, ankesat nga të tretët, etj është i ngritur **Autoriteti i Mbikqyrjes Audiovizive (AMA)**, e cila ka të ngritur edhe një Këshill Ankesash, që ka për objekt të punës mbikëqyrjen e zbatimit të kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë sidomos me respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, të drejtës për informacion dhe sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive. Në këtë ligj parashikohet edhe funksionimi i Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) si një person juridik publik, jo me qëllim fitimi, me seli në Tiranë, që kryen shërbimet e transmetimit publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Përcaktohet se RTSH-ja është një operator i përkushtuar ndaj idealeve më të larta të transmetimit të shërbimit publik kombëtar, RTSH-ja realizon shërbime cilësore radioje dhe televizioni për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë dhe pakicat kombëtare. Organet drejtuese të RTSH-së janë: a) Këshilli Drejtues (KDRTSH). b) Drejtori i Përgjithshëm. c) Bordi i Administrimit.

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”- Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin, që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit. Cdo autoritet publik vë në zbatim një program transparence, pra publikimin e informacioneve në faqen e tij online, që ai i çmon të dobishme për publikun. Koordinatorin për të drejtën e informimit është pika e kontaktit mes publikut dhe autoritetit publik, që duhet të ofrojë informacionin. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar; c) të drejtën e autorit; ç) patentat. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti i pavarur përgjegjës për shqyrtimin e ankesave, monitorimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të këtij ligji. imin e ankesave, monitorimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

Ligji nr.9887, datë 10. 3. 2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”- Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale. Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private. Me “të dhëna personale” kuptohet çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Ligj¹⁸ nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”- Ky ligj ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për promovimin e përdorimit të të dhënave të hapura në Republikën e Shqipërisë me synim nxitjen e inovacionit në ofrimin e produkteve dhe të shërbimeve. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për të drejtën e ripërdorimit të të dhënave të hapura për qëllime fitimi ose jo të dokumenteve, që mbahen nga organet e sektorit publik ose sipërmarrjet publike në Republikën e Shqipërisë.

Ligji nr.10/ 2023 “Për informacionin e klasifikuar”- Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve bazë dhe i rregullave për krijimin, administrimin, deklasifikimin, zhvlerësimin dhe mbikëqyrjen e informacionit të klasifikuar gjatë gjithë ciklit jetësor të tij, me qëllim mbrojtjen e informacionit të klasifikuar nga humbja, dëmtimi, rrjedhja, komprometimi ose ekspozimi i paautorizuar. Ky ligj zbatohet nga institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë të cilët gjatë ushtrimit të detyrave të tyre kërkojnë të kenë qasje në informacionin e klasifikuar. “Informacioni i klasifikuar ‘Sekret shtetëror’” është çdo dokument ose material, pavarësisht nga forma dhe natyra e tij, i përgatitur ose që përgatitet, të cilit i është vendosur një nivel i caktuar klasifikimi dhe afat ruajtjeje klasifikimi në përputhje me këtë ligj, në interes të sigurisë kombëtare dhe mbrohet nga shkatërrimi, humbja, vjedhja, rrjedhja, përhapja e paautorizuar ose qasja nga çdo lloj tjetër komprometimi siguri ligji nr. 8454, datë 4.2.1999 “PËR AVOKATIN E POPULLIT”, i ndryshuar - Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të avokatit të popullit. Avokati i popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend. Avokati i popullit i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, të parashikuara në dispozita kushtetuese dhe në ligje. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për mbrojtjen e të drejtave të të huajve, të cilët janë ose jo, rezidentë të rregullt në shqipëri, të refugjatëve, azilkërkuessve si dhe të personave pa shtetësi, që ndodhen në territorin e republikës së shqipërisë, sipas kushteve të parashikuara në ligj.

Ligji nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”- është një ligj novator, që nuk ka ekzistuar më parë dhe ka për objekt përcaktimin e rregullave për bashkëqeverisjen me qytetarët nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje, garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse, rritjen e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies së administratës shtetërore përmes platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”. Ky ligj zbatohet nga institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, si dhe nga entet publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas kushteve dhe përcaktimeve të vetë ligjit. Në kuadrin e këtij ligji, qytetarët dhe grupet e interesit kanë të drejtë të paraqesin ankesa, deri dhe të kërkojnë interpelancë me Kryeministrin apo anëtarët e Këshillit të Ministrave. Strukturat shtetërore përgjegjëse për bashkëqeverisjen me qytetarët janë:

publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas kushteve dhe përcaktimeve të vetë ligjit. Në kuadrin e këtij ligji, qytetarët dhe grupet e interesit kanë të drejtë të paraqesin ankesa, deri dhe të kërkojnë interpelancë me Kryeministrin apo anëtarët e Këshillit të Ministrave. Strukturat shtetërore përgjegjëse për bashkëqeverisjen me qytetarët janë:

a) Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje;

¹⁸ Ky ligj është përafruar pjesërisht me: direktivën (BE) 2019/1024 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 qershor 2019, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, numri CELEX32019L1024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 172, datë 26.6.2019, f. 56–83.

b) institucionet e administratës shtetërore.

V. ANALIZA E KUADRIT INSTITUCIONAL NË SHQIPËRI NË FUSHËN E MEDIAVE

Nga kuadri ligjor i referuar më lart burojnë edhe institucionet apo organizmat shtetërore të ngarkuara me zbatimin e tij. Në vijim po rendisim institucionet kryesore shtetërore, që ushtrojnë kompetenca në çështjet e mediave, lirisë së shprehjes, së drejtës së informimit, etj.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) - AMA është person juridik publik, i pavarur, me seli në Tiranë dhe vepron si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë. AMA ka në përbërje një kryetar, një zëvendëskryetar dhe 5 anëtarë, të gjithë zgjidhen nga Kuvendi me mandat 5- vjeçar. Objektivat e veprimtarisë së AMA-s janë: AMA, në ushtrimin e funksioneve të veta, siguron:

- a) që të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimeve fetare, kulturës dhe moralit të qytetarëve;
- b) ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias;
- c) ofrimin e shërbimeve të shumëllojshme dhe pa pagesë.

Ndër kompetencat kryesore të AMA-s janë:

- a) shqyrtimi i propozimeve dhe aplikimeve për ushtrimin e shërbimeve të transmetimit, përfshirë aplikimet për transmetime numerike dhe dhënia e autorizimeve ose licencave përkatëse, në përputhje me këtë ligj, përfshirë shërbimet e ofruara nga RTSH-ja;
 - b) lëshon dhe heq licencat dhe/ose autorizimet me shumicë të cilësuar;
 - c) garantimi i konkurrencës së ndershme, duke siguruar njëkohësisht zhvillimin e mëtejshëm të RTSH-së;
 - ç) bashkëpunimi me Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit për garantimin e mbrojtjes së konsumatorëve në fushën e mediave elektronike, në rastin e praktikave të pandershme të OSHMAve dhe të ofrimit të shërbimeve me çmime abuzive;
 - d) hartimi i strategjive për ofrimin e shërbimeve të transmetimit në Republikën e Shqipërisë;
 - dh) mbikëqyrja e zbatimit të kontratës së shërbimit të lidhur me RTSH-në;
 - e) hartimi dhe miratimi i kodit dhe rregulloreve të transmetimit audioviziv dhe akteve të tjera nënligjore, në zbatim të këtij ligji; ë) hartimi dhe miratimi i rregulloreve për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave dhe/ose autorizimeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
 - f) përcaktimi i pagesave për licencat;
 - g) përgatitja dhe nxjerrja e udhëzimeve për RTSH-në, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të tij;
 - gj) përcaktimi i kriterëve dhe masave rregulluese për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së;
 - h) zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik;
 - i) bashkëpunimi me ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave;
 - j) bashkëpunimi dhe këshillimi me AKEP-in, Autoritetin e Konkurrencës, Zyrën e të Drejtave të Autorit dhe organet e tjera në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.
- AMA raporton në Kuvend, jo më vonë se **data 31 mars i çdo viti**, për mënyrën e përmbushjes së funksioneve dhe veprimtarive të veta për vitin paraardhës, përfshirë raportimin për realizimin

e planit financiar. Raporti vjetor duhet të përfshijë informacion mbi zhvillimin e transmetimeve në drejtim të personave me nevoja të veçanta shqisore dhe veçanërisht zhvillimin e arritur për qëllimet e përcaktuara në rregulloren e transmetimit. AMA, mund të paraqesë raporte në lidhje me funksionet e veta, në bazë të kërkesës së Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale është autoriteti përgjegjës si për ligjin “Për të drejtën e informimit”, edhe për ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Në kuadrin e ligjit të parë, Komisioneri ka për kompetencë shqyrtimin e ankesave të personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre në kuadër të ligjit “Për të drejtën e informimit”, ndërsa në rastin e ligjit të dytë Komisioneri mbikëqyr dhe monitoron, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në nenin 30, pika 2, të ligjit nr.9887, datë 10. 3. 2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar parashikohet se: “... Komisioneri, në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.” Pra Komisioneri i ka instrumentet ligjore të reagimit dhe të ndërgjegjësimit të publikut apo të institucioneve më të larta në rastet e shkeljeve serioze të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

Avokati i Popullit është institucion kushtetues, që mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai ka si mision të tij parandalimin e konflikteve të mundshme midis administratës publike dhe individit. Avokati i Popullit vepron në bazë të ankesës apo kërkesës së paraqitur pranë tij. Ai vepron edhe me nismën e vet, për raste të veçanta, të bëra publike, por gjithmonë duhet të marrë më vonë pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit. Në mbrojtje të interesave të një komuniteti të gjërë, të cilët mund të preken nga procedimi administrativ, Avokati i Popullit ka të drejtë të fillojë një procedim administrativ dhe të marrë pjesë në të, në përputhje me kërkesat e Kodit të Procedurës Administrative. Avokati i Popullit nuk vendos direkt vetë për t’ju dhënë të drejtat personit që ankohet, por bën rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi i administratës publike që sipas tij ka shkaktuar shkeljen e saj. Në rastet kur organi përkatës nuk reagon ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ky i fundit mund t’i drejtohet shkallë-shkallë organeve më të larta në hierarki, deri edhe Kuvendit me një raport, duke propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Duke qenë se Avokati i Popullit mbron të drejtat dhe liritë kushtetuese, ai herë pas here ka përgatitur raporte, reagime publike në mbrojtje të lirisë së shprehjes, të lirisë së medias dhe posaçërisht të komunitetit të gazetarëve.

Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është person juridik publik, qendror në varësi të Kryeministrit dhe përgjigjet për bashkëqeverisjen me qytetarët nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje, për garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse, si dhe për rritjen e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore. Ndër kompetencat e Agjencisë janë:

- zhvillon mekanizmat dhe monitoron zbatimin e tyre për gjithëpërfshirjen e qytetarëve në politikëbërje;

- garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjen e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore;
- koordinon nëpërmjet mekanizmeve të posaçëm institucionalë institucionet e administratës shtetërore për zhvillimin e praktikave të mira dhe përdorimin e tyre në të gjithë administratën shtetërore për gjithëpërfshirjen e çdo qytetari në politikëbërje;
- garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjen e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së administratës shtetërore;
- publikon dhe informon publikun në mënyrë të vazhdueshme për çdo veprimtari për rritjen e rolit të qytetarëve në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike, si dhe ndërmarrjen e nismave, të projekteve ose të programeve të përbashkëta;
- shqyrton kërkesat dhe organizon në bashkëpunim me institucionin përkatës të administratës shtetërore interpelancat e Kryeministrit, të zëvendëskryeministrit dhe të ministrave me grupet e interesit, sipas kërkesës së tyre, për çështje me interes publik ose komunitar, me përjashtim të takimeve publike që organizohen sipas ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik;

ndërmjetëson zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet institucionit të administratës shtetërore, qytetarëve apo subjekteve private sipas përcaktimeve të këtij ligji, etj.

VI. GJETJET NGA INTERVISTAT E THELLUARA

Gjatë kohës së hartimit të këtij studimi janë kontaktuar dhe zhvilluar intervista me institucionet kryesore shtetërore, që kanë lidhje me fushën e medias. Lista e plotë e institucioneve të kontaktuar është në aneksin 1 të këtij studimi. Përfaqësuesit e institucioneve janë ftuar edhe në një takim online. Shumë prej tyre preferuan që t’iu dërgohet një intervistë me pyetje dhe do të na i dërgonin përgjigjet. Ju janë dërguar të gjithëve pyetjet përkatëse, një pjesë u janë përgjigjur me email dhe një pjesë tjetër ende nuk i kanë dërguar përgjigjet e tyre. Në vijim intervistat me përgjigjet përkatëse.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale e kontaktuar në këtë proces, thekson se e drejta për informim dhe mbrojtja e jetës private/të dhënave personale, janë dy të drejta dhe liri themelore të qytetarit, të cilat janë të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, respektivisht në nenin 23 dhe atë 35. Institucioni funksionon si institucion i pavarur i administratës publike, i cili që nga viti 2008 (ndryshuar në 2014) monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar dhe atë nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre. Zyra e Komisionerit udhëhiqet nga parimet e transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, duke patur gjithnjë në fokus interesin publik. Si institucioni mbikëqyrës i zbatimit të legjislacionit që garanton dy të drejta dhe liri themelore të njeriut – të drejtën për qasje në informacionin/dokumentacionin me karakter publik dhe atë për mbrojtjen e të dhënave personale, institucioni ushtron një aktivitet të gjerë njohës dhe ndërgjegjësues. Vlen të theksohet fakti, se gjatë viteve të fundit, me forcimin e standardeve ligjore ka një reagim pozitiv dhe përmirësim të kulturës së zbatimit të detyrimeve të kuadrit rregullator, si në sferën publike ashtu edhe në atë private. Ky është një proces i vazhdueshëm dhe që ka anë pozitive e aspekte për të cilat duhet punuar ende, në sjelljen e tyre në parametrat e duhur.

Instrumenti kryesor raportues mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit është Raporti Vjetor që i paraqitet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë¹⁹ dhe nga ana tjetër, instrumenti vlerësues mbi ecurinë e zbatimit të kuadrit ligjor dhe përmbushjes së detyrave të lëna nga ligjvënësi është Rezoluta e tij²⁰. Megjithatë, të dyja këto fusha janë në zhvillim dinamik, çka ka sjellë përmirësimin e legjislacionit të të drejtës për informim, dhe së shpejti, miratimin e një ligj të ri për mbrojtjen e të dhënave personale që transponon plotësisht Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian (GDPR). Me këto akte rriten ndjeshëm standardet rregullatore kombëtare, sipas atyre më bashkëkohore sot në hapësirën kontinentale (BE dhe Këshilli i Evropës).

Lidhur me cënimin e së drejtës për informim në rastet e ushtrimit të saj nga gazetarët apo mediat, ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i garanton çdo qytetari të drejtën e ankesës në rast të mosmarrjes së informacionit të kërkuar pranë autoriteteve publike. Që nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji, për aq sa është e mundur të identifikohen, ai përdoret edhe nga gazetarë apo subjekte mediatike. Procesi i shqyrtimit të ankesës sipas nenit 24 të LDI është i harmonizuar me parashikimet e ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative. Nga të dhënat që disponohen (Raportet Vjetore 2020, 2021 dhe 2022) ka një rritje të numrit të ankesave të gazetarëve/subjekteve mediatike krahasuar me numrin e qytetarëve. Legjislacioni për të drejtën e informimit ka parashikuar edhe instrumentet e Programit të Transparencës dhe Regjistrin e Kërkesa dhe Përgjigjeve, që përbëjnë, burimin kryesor të marrjes së informacionit/dokumentacionit nga cilido. Përditësimi i vazhdueshëm i tyre forcon akoma edhe më shumë transparencën proaktive të autoriteteve publike, përmirëson llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve/publikut në vendimarrje.

Problemet kryesore të evidentuara nga diskutimet me organizatat e mediave në vend, gazetarë dhe njohës të fushës, në sinkron me vlerësimet e organizatave ndërkombëtare të trajtuara më sipër, konsistojnë kryesisht në çështjet e mëposhtëme:

- **Frikësimi përmes ligjit të ashpër penal kundër lirisë së shprehjes**, e vlefshme kjo për gazetarët por edhe për qytetarët. Shqipëria vijon të mbajë një regjim penal kundër shpifjes dhe fyerjes, me masa ndëshkimi që arrijnë deri në 29 mijë euro. Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve të OSBE-ODIHR ka përsëritur përgjatë viteve të fundit nevojën për shfuqizimin e këtyre neneve në Kodin Penal dhe trajtimin e shpifjes dhe fyerjes vetëm në kuadër të Kodit Civil. Bashkë me shumë rekomandime të tjera në lidhje me zgjedhjet dhe standardet demokratike, kjo këshillë nuk është ndjekur nga politikëbërësit shqiptarë. Edhe Komisioni Evropian, në mënyrë të përsëritur përgjatë viteve, ka kërkuar të njëjtën gjë, e cila ka mbetur e pazbatuar.
- politikëbërësit shqiptarë. Edhe Komisioni Evropian, në mënyrë të përsëritur përgjatë viteve, ka kërkuar të njëjtën gjë, e cila ka mbetur e pazbatuar.
- **Situata thuajse monopol në tregun audioviziv**. Të dhënat e tregut audioviziv flasin për një shkallë të lartë përqendrimi, ku dy operatorët kryesorë, kontrollojnë më shumë se 50% të tregut të matur sipas të ardhurave. Dhe për më shumë, ndryshe nga sa kërkohet nga parimi i ndarjes së pronësisë nga administrimi në fushën e medias, këto kompani janë që të dyja biznese familjare. Shqipëria ka pasur në të shkuarën një nen që kufizonte pronësinë në kompanitë me

¹⁹ <https://www.idp.al/raporte-vjetore/>

²⁰ <https://www.idp.al/rezolutat-e-kuvendit/>

licencë kombëtare në 40% për investitorët individualë, gjë që u shfuqizua si “disproporcionale me qëllimin” nga ana e Gjykatës Kushtetuese disa vite më parë. Që nga ajo kohë, Kuvendi të Shqipërisë i duhej të përgatisë një kufizim tjetër, i cili duhet të jetë “proporcional me qëllimin”, gjë për të cilën nuk ka plane se mund të kryhet së shpejti apo në të ardhmen. Problemi tjetër i karakterit ligjor është një vendim kontrovers i Autoritetit të Konkurrencës, i cili ka shpallur se mediat, si aktivitete të rregulluara nga një ligj i veçantë, nuk rregullohen nga AK por nga AMA. Kjo ka bërë të pamundur zhbërjen e situatës monopoliste në tregun e hostuesve të televizioneve, ku nga shtatë licencat, dy i kontrollon TVSH, e cila ka vendosur çmim pengues për hostimin, tre i kontrollon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte një media, dhe dy të tjera nga dy media të tjera. Në thelb, kuadri aktual ligjor konsiderohet i mangët sa i përket kufizimit të pronësisë si dhe parimit të larmshmërisë së burimeve të informacionit.

- ufizimit të pronësisë si dhe parimit të larmshmërisë së burimeve të informacionit.
- **Financimi jotransparent i medias nga qeveria përmes reklamave qeveritare**, por më së shumti, përmes favoreve ekstraligjore. Kjo çështje lidhet me përjashtimin që nga viti 2007 në mënyrë eksplicite të reklamave qeveritare nga Ligji për Prokurimin publik, gjë që autorizon institucione të ndryshme të japin reklama për media të caktuara pa transparencë dhe pa garë. Komisioni Evropian në raportin vjetor të Progresit ka përsëritur në mënyrë të vazhdueshme kërkesën për rregullimin e reklamave qeveritare sipas standardeve të BE-së, gjë që do të thotë, garë dhe transparencë. Në këtë kontekst duhet të theksohet se financimet më të mëdha të qeverisë për mediat duket se nuk vijnë nga reklamat por nga favorizimet përmes instrumenteve preferenciale ligjore, të tilla si “Ligji për Investimet Strategjike”, ku problemi i ligjit nuk i përket vetëm medias.
- erisë për mediat duket se nuk vijnë nga reklamat por nga favorizimet përmes instrumenteve preferenciale ligjore, të tilla si “Ligji për Investimet Strategjike”, ku problemi i ligjit nuk i përket vetëm medias.
- **Palët e treta dhe platformat.** Kjo çështje lidhet me kërkesat e vazhdueshme të OSBE-ODIHR për etiketimin e përshtatshëm të materialeve propagandistike të prodhuara nga zyrat e shtypit të qeverisë gjatë transmetimeve të tyre në media si dhe rregullimin e financimeve elektorale nga të ashtuquajturat “palë të treta”. Bëhet fjalë për grupe interesi apo portale, të cilat, pasi prezantohen në publik si media të pavarura apo nisma të rinjsh, përdorin para politike për të pompuar propagandë të palëve duke anashkaluar kufizimet e Kodit Zgjedhor mbi shpenzimet elektorale.
- **Mungesa ligjore e statusit të gazetarit**, i vendos gazetarët në një pozitë të njëjtë me qytetarët e thjeshtë në përballjen me ligjin, ndryshe nga profesionet e tjera të njohura dhe rregulluara me ligj. Si pasojë e zhvillimeve teknologjike dhe përhapjes së mediave online profesioni i gazetarit është duke u përballur me sfida të rëndësishme të cilat përfshijnë vecmas problemeve specifike të mësipërme, edhe pasigurinë në punë, kushtet e punës apo atyre të barazisë gjinore në punë. Për këto arsye përcaktimi i statusit të gazetarit bëhet i nevojshëm, përfshirë rastet e gazetarëve freelance, duke diktuar dhe nevojën e rishikimit të legjislationit të punës në këtë fushë. Nga ana tjetër, përcaktimi i statusit të gazetarit përballet gjithashtu me sfidën e institucioneve që do të përcaktojnë këtë status, kriteret dhe standartet që ato do të përdorin për këtë qëllim duke mos cënuar apo penguar lirinë e të shprehurit dhe atë të mediave në vend.
- **Konteksti politik**, ekonomik dhe social në vend përgjithsisht nuk e favorizon si duhet zhvillimin e lirisë së medias në vend, duke deformuar rolin e shëndetshëm të saj në

shoqëri. Praktika ka treguar në raste të caktuara që edhe kur mungon organizimi tradicional vertikal që nis nga pronësia e medias, (si psh. në media online), liria e gazetarit ndodh që priret drejt anarkisë apo abuzimit. Liria e medias kërcënohet po ashtu nga të drejtat e punës në profesionin e gazetarit, informaliteti në punësimin në media, problematikën e pagave dinjitoze dhe të paguara në kohë, pabarazinë profesionale, rajonale apo gjinore etj.

Avokati i Popullit, më 2 Nëntor 2023, në Ditën Ndërkombëtare për Dhënien Fund të Pandëshkueshmërisë ndaj Krimeve Kundër Gazetarëve bëri një reagim publik, ndër të tjera se: "...duhet të reflektojmë mbi rëndësinë e medias së lirë dhe riskun që shpesh gazetarët mbartin për të zbardhur të vërtetën. Institucionet dhe e gjithë shoqëria duhet të jenë më të ndjeshme ndaj çdo akti dhune që cënon integritetin personal dhe profesional të çdo gazetari, i cili duhet ta ushtrojë detyrën e tij pa kosto për jetën. Rikujtesa e vazhdueshme kundër këtij fenomeni sjell në vëmendje rëndësinë e lirisë së shtypit, si dhe rolin thelbësor që luajnë gazetarët në shoqëri. Gjithashtu, kjo ditë duhet të shërbejë për të inkurajuar të gjithë gazetarët që profesionin e tyre ta konsiderojnë një mision ndaj shoqërisë, sepse përmes çdo fjale që përcjellin me besueshmëri dhe maturi, ata kanë fuqinë për të frymëzuar ndryshim. Së bashku për të dënuar dhunën kundër gazetarëve dhe të ecim drejt një shoqërie ku guximi i tyre përballet me respekt dhe jo me hakmarrje!"

Të kontaktuar nga ana jonë përfaqësues të Platformës për Sigurinë e Gazetarëve të Këshillit të Europës, për shkak të një procedure të posaçme, që nevojitej për t'iu ëërgjigjur intervistës tonë për gjendjen e mediave dhe të drejtat e gazetarëve në Shqipëri na referuan te raporti i fundit i 18 Nëntorit 2022, që ata kishin përpiluar për vendin tonë mbi lirinë e shtypit, pluralizmin e medias dhe sigurinë e gazetarëve në Shqipëri. Ndër të tjera veçojmë nga gjetjet e tyre: "Vlerësimi ynë është se në përgjithësi Shqipëria vazhdon të përjetojë një përkeqësim të lirisë së medias. Ndërkohë që kuadri ligjor mbetet përgjithësisht i përshtatshëm, nuk është bërë asnjë progres në vitet e fundit në përmirësimin e mjedisit mundësues për gazetarinë e pavarur dhe pluralizmin mediatik.

Puna e policisë në hetimin e shpejtë të sulmeve ndaj gazetarëve dhe zbatimin e masave disiplinore për rastet që përfshijnë oficerë të zbatimit të ligjit është gjithashtu e mirëpritur. Inkurajuese janë edhe informacionet që ka marrë delegacioni për nismat për trajnimin e punonjësve të policisë për rolin dhe të drejtat e gazetarëve. Organizatat tona mirëpresin gjithashtu rritjen si në numër ashtu edhe në cilësi të përgjigjeve të shtetit ndaj alarmeve që përfshijnë kërcënime ndaj lirisë së medias në Platformën e Këshillit të Evropës për Sigurinë e Gazetarëve.

e Këshillit të Evropës për Sigurinë e Gazetarëve.

Pavarësisht këtyre hapave inkurajues, perceptimi dërrmues i përfaqësuesve të medias ishte se klima për raportim të lirë dhe të pavarur në Shqipëri po përkeqësohej. Ky perceptim reflektohet nga rritja e numrit të sinjalizimeve për lirinë e medias të postuara në Platformë, duke përfshirë sulmet ndaj gazetarëve, retorikën diskredituese nga politikanët dhe shqetësimet për klimën kufizuese për qasjen në informacion.

Megjithatë, shkaku kryesor i shumë prej kërcënimeve ndaj gazetarisë së pavarur në Shqipëri vazhdon të jetë kapja e pjesëve të rëndësishme të mjedisit mediatik nga interesat e biznesit. Këta pronarë mediash, shumë prej të cilëve kanë pronësi edhe industri kyçe të rregulluara nga shteti që mbështeten në tendera publikë, përdorin sistematikisht asetet e tyre mediatike për t'i shërbyer axhendave të tyre private ose politike në vend të interesit publik. Vitet e fundit është intensifikuar përqendrimi i mediave nën kontrollin e grupeve të tilla biznesi. n kontrollin e grupeve të tilla biznesi.

Rezultati është se ndërhyrja e drejtpërdrejtë e pronarëve të mediave në pavarësinë editoriale është e lartë dhe disa çështje apo tema të ndjeshme konsiderohen të palejueshme për gazetarët. Këto praktika pronësie kanë minuar prej kohësh besimin e publikut në integritetin e medias dhe çojnë në autocensurë kronike brenda komunitetit gazetaresk dhe mungesë të raportimit investigativ cilësor.

Në fushën e rregullimit të medias, emërimet e politizuara në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) vazhdojnë të shtrojnë pikëpyetje serioze mbi pavarësinë e këtij organi.

Një nga çështjet më urgjente për punën e përditshme gazetareske vazhdon të jetë mungesa e transparencës dhe qasjes në informacion. Gazetarët shpërfillen rregullisht kur kërkojnë informacione ose komente nga autoritetet publike dhe zyrtarët. Në të gjitha nivelet e qeverisjes, gazetarët ende përballen me barriera në parashtrimin e pyetjeve ose në shqyrtimin e duhur të atyre që janë në pushtet.

Siguria e gazetarëve vazhdon të jetë një problem. Ndërsa sulmet e rënda fizike mbeten të rralla, rastet e fundit të dhunës ndaj gazetarëve nënvizojnë kërcënimet me të cilat përballen profesionistët e medias për shkak të punës së tyre. Vonesat në përpjekjet për të sjellë para drejtësisë përgjegjësit e sulmeve rezultojnë në mosndëshkim.

Vazhdojnë përpjekjet e figurave politike të profilit të lartë për të diskredituar dhe denigruar gazetarët kritikë.

Dënimet me burg për shpifje u shfuqizuan në vitin 2012, shpifja dhe fyerja mbeten vepra penale të dënueshme me gjobë. Një rast në Platformë që përfshin një padi për shpifje të ngritur kundër një gazetari nga ish-kryeprokuroerja e Tiranës për raportimin e tij për procesin e vetingut të saj është një shembull shqetësues se si këto ligje vazhdojnë të abuzohen nga figura të pushtetshme që synojnë të heshtin gazetarinë kritike.

Vetëcensurimi mes gazetarëve është një sfidë sistematike e përkeqësuar nga kushtet e këqija të punës dhe të drejtat e punës për profesionistët e medias. Pagesa e ulët dhe paqëndrueshmëria profesionale i lënë gazetarët të prekshëm ndaj presionit nga pronarët e mediave.”


Gazetarja Anila Hoxha e kontaktuar nga ana jonë na ripërsëriti konstatimet e saj, që kishte ndarë edhe me pjesëmarrësit në organizimin “South East Europe Media Forum”, në seksionin “Media and Politics Albania” (Nëntor 2023), se: “Disa nga sfidat me të cilat po përballen gazetarët në Shqipëri janë:

1. Mungesa e transparencës, ndonëse ligji 119/ 2014 rregullon të drejtëen për njohjen e informacionit, në praktikë gazetarët ndeshen me bllokadë kur vjen fjala tek dokumentat shkresore veçanërisht në fushën e tenderave. Shumë gazetarë zvarriten në Gjykatën Administrative, mbasi Komisioneri nuk ju dha të drejtë për të disponuar mbi materialet e kërkuara.
2. Mungesa e sigurisë dhe mos hetimi i kanosjeve, kërcënimeve dhe sulmeve ndaj punonjësve të medias, të çdo natyre qofshin ato. Sulmet verbale , diskriminuese vazhdojnë të jenë prezente jo vetëm nga të zgjedhurit, por edhe në platformat online ;
3. Kushtet e punës dhe kontratat, pagesat ende me dy bordero. Gazetarët e rinj po hasin vështirësi, që janë në shkelje të Kodit të Punës. Koncepti i mbajtjes në provë në mënyrë të përhershme u krijon pasiguri dhe mungesë stabiliteti në ushtrimin e profesionit dhe misionit të tyre. »

VII. HAPËSIRAT PËR RREZIK KORRUPSIONI DHE PËRMIRËSIMI I ROLIT LIGJBËRËS DHE MBIKËQYRËS TË KUVENDIT NË SEKTORIN E MEDIAS NË SHQIPËRI

Çdo projektligj duhet t'i nënshtrohet një analize profesionale për të konstatuar, nëse ka hapësira për rrezik korrupsioni. Edhe në studimet pararendëse për fushat e tjera të zgjedhura si me risk të lartë është zbatuar e njëjta metodologji analize për hapësirat eventuale për korrupsion, shih skemën në vijim: a) dykuptueshmëria dhe b) rreziqet substanciale.

Figura 1: Kategoritë e kriterëve për vlerësim të hapësirave korruptive



Gjatë periudhës së hartimit të këtij studimi, nuk kanë qenë të depozituara në Kuvend për shqyrtim projektligje që prekin drejtëpërdrejtë apo indirekt lirinë e medias, lirinë e shprehjes apo të drejtat e gazetarëve.

Ndërkohë që ishte për diskutim dhe është miratuar nga Kuvendi **me datën 21. 9. 2023** një ligj²¹ ndryshues, i ligjit nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, që ka për synim të forcojë më tej pozitën juridike të **Komisionerit²² për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**, duke i dhënë kompetenca të plota për të ushtruar detyrën e tij si autoritet i pavarur përgjegjës për shqyrtimin e ankesave, monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji. Në këtë mënyrë duket se e drejta për informim mund të ushtrohet pa vonesa, pa pengesa burokratike duke iu ofruar çdo të interesuari, që ka nevojë për informacion nga institucionet shtetërore.

A. Analiza e projektligjeve që ndikojnë në lirinë e medias

i) Ligji nr. 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””

Në këtë fazë që ligji është miratuar, për më tepër është një ligj ndryshues dhe jo tërësor nuk është e mundur që t'i bëjmë një analizë për hapësirat eventuale për korrupsion, por do të analizojmë në vijim risitë që sjell dhe cilat janë problematikat që mbeten të pazgjidhura.

Risitë e ligjit ndryshues:

- Ligji parashikon detyrimin për përditësimin e informacionit çdo herë që pëson ndryshime, duke treguar, gjithashtu, datën e përditësimit të fundit. Kjo është një masë që synon rritjen e transparencës së organeve publike duke i siguruar publikut informacion të përditësuar dhe që i shërben qëllimit që ka në thelb e drejta për informim.
- Është shtuar një dispozitë e re me titull “Komisioneri për të drejtën për informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale”, që ka qenë e parashikuar në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, por për teknikë legjislativë, por dhe për lidhje organike është konceptuar me këtë ligj ndryshues, si pjesë e ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”.
- Me dispozitat e reja ofrohen zgjidhje më optimale në njohjen me informacionin publik, një sjellje më të përgjegjshme të administratës publike dhe, për rrjedhim, reduktimin e hapësirave për korrupsion dhe rritjen e besimit të publikut tek autoritetet publike.
- Koordinatori për të drejtën e informimit dhe titullari i autoritetit publik do të mbajnë përgjegjësi jo vetëm për kundërvajtjet për të cilat ngarkohen me përgjegjësi administrative shprehimisht, por edhe për kundërvajtjet e tjera për të cilat provohet se shkelja ka ardhur si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të tyre. Pra, në rrethin e personave përgjegjës do të përfshihen koordinatori, titullari i autoritetit publik, si dhe çdo person tjetër i cili me veprimet ose mosveprimet e tij ka sjellë si pasojë shkeljen e dispozitave të ligjit.
- Janë rishikuar kufijtë minimalë të gjobave që vendosen për shkeljen e dispozitave të këtij ligji. Ky rishikim diktohet nga mungesa e proporcionalitetit ndërmjet masës së gjobës, që aktualisht aplikohet ndaj koordinatorit për të drejtën e informimit ose

²¹ Ligj nr. 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014“Për të drejtën e informimit””, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 152, datw 20. 10. 2023;

²² <https://www.idp.al/>

personit përgjegjës, në raport me pagën e tij. Në disa raste, të zbatuara edhe në praktikë, kufiri minimal i masës së gjobës ka rezultuar të jetë disa fish më i madh se paga e nëpunësve publikë dhe vendosja e një mase të tillë gjobe i shkakton një dëm të konsiderueshëm kushteve ekonomike dhe jetesës së nëpunësit. Dënimi administrativ ka si synim kryesor parandalimin e shkeljes së ligjit, si dhe ndërgjegjësimin e shkelësit dhe jo thjesht dënimin e tij.

- Në këtë ligj ndryshues për të ndërgjegjësuar institucionet për të zbatuar vendimet e Komisionerit janë parashikuar edhe gjopa në rastet e moszbatimit të tyre.
- Në mënyrë që dispozitat mos të mbeten deklarative, por të jenë të zbatueshme dhe të detyrueshme për subjektet e ngarkuara është parashikuar që ato bashkëpunojnë me Komisionerin, si dhe i raportojnë atij çdo vit deri me datën 31 të muajit janar të vitit pasardhës. Në këtë kuptim edhe Komisioneri mund ta përgatisë më të saktë raportimin e tij vjetor para Kuvendit, si dhe të ketë informacionin e duhur bazuar tek i cili mund të propozojë masa për përmirësimin e situatës.
- Pra ligji ndryshues përforcon pozitën juridike të Komisionerit, si dhe rrit garancinë se institucionet shtetërore dhe koordinatorët për të drejtën e informimit do t'i përmbushin me korrektesë detyrat që iu rrjedhin nga ligji "Për të drejtën e informimit".

Problemet e pazgjidhura:

- Qytetarët apo subjektet e tjerë nuk do të kërkonin shumë informacion nëse programi i transparencës i publikuar në faqen online të një institucioni do të ishte i plotë, pasi do të informoheshin në kohë reale për çështjet kryesore për të cilat po merreshin vendime nga ai institucion. Ajo çfarë konstatohet është se ky është një program skematik, pa dinamikën e veprimtarisë së vetë institucionit, pavarësisht se në nenin 4, të ligjit nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar parashikohen ndër të tjera parimet mbi bazën e të cilave përgatiten programet e transparencës, ndër to merren për bazë edhe modelet e miratuara nga Komisioneri (KDIMDP), sërish këto programe nuk përmbushin pritshmëritë e publikut. Sugjerimi ynë do të ishte, meqenëse merren për bazë modelet e miratuara nga Komisioneri, atëherë për institucione me tipologji të ngjashme të ngrihen grupe interesi, të cilët konsultohen dhe të diskutohen paraprakisht pritshmëritë e tyre për një program transparence. P.sh nëse marrim dy drejtori të përgjithshme të ngjashme, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve²³ dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave²⁴ bëhet një konsultim paraprak me dhomat e tregtisë dhe të industrisë, se cilat informacione ata kërkojnë që të jenë te programi i transparencës dhe më pas miratohet modeli për këto institucione. Kjo mënyrë veprimi do t'i ndihmonte subjektet, që të informoheshin në kohë reale për çështjet që atyre iu interesojnë, pa patur nevojë të bëjnë kërkesa për informacion.

ii) Rekomandimet²⁵ e Kuvendit për Autoritetin e Mbikqyrjes Audiovizive për vitin 2023

Kuvendi i Shqipërisë²⁶ për vitin 2023 ka miratuar nëntë rekomandime për AMA-n, ndër to po evidentojmë dy shumë të rëndësishme për studimin tonë:

²³ <https://www.tatime.gov.al/c/545/programi-i-transparences;>

²⁴ <https://dogana.gov.al/programi-i-transparences.php;>

²⁵ <https://qbz.gov.al/eli/rezolute/2023/07/06/2222-8/aa7bd3d3-d091-4b2f-b441-a7c25ca61063;>

²⁶ <https://www.parlament.al/lajme/%206c285006-9d79-41b7-85d6-e629dbb0c42f;>

“1. Në zbatim të ndryshimeve ligjore të miratuara në lidhje me transparencën e pronësisë së mediave, AMA të marrë të gjitha masat që Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA) të bëjnë publik informacionin në lidhje me strukturën e tyre të pronësisë, duke përfshirë edhe pronarët përfitues, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

4. AMA duhet të jetë më aktive dhe reaguese në rastet e kanosjeve dhe sulmeve kundër gazetarëve, si dhe në rastet e kërcënimeve ndaj medias ngado që ato vijnë.”

- Në lidhje me rekomandimin e parë duhet verifikuar nëse AMA ka nxjerrë akte të brendshme për të ushtruar kontrole/vëzhgime periodike nëse OSHMA-të i kanë bërë publike këto informacione, si dhe masat që ka marrë në rastet, kur nuk është zbatuar ky detyrim ligjor nga ana e tyre. Ky verifikim duhet kryer për gjatë gjithë vitit 2023 e më pas duhet konkluduar, nëse është zbatuar si duhet si rekomandim, apo ka mbetur me zbatim spontan dhe rast pas rasti. Duke marrë shkas nga ky rekomandim mund ta zgjerojmë më tej diskutimin për raportin e medias me pushtetin shtetëror dhe pushtetin ekonomik. Një nga problemet bazë të konstatuara nga reagimet e shoqërisë civile është lidhja okulte²⁷ e pronarëve të caktuar të mediave audiovizive me segmente të pushtetit shtetëror apo me subjektet që gëzojnë pushtet ekonomik në vend. Kjo lidhje okulte ka çuar në pasurim të pakuptueshëm të pronarëve të mediave, si dhe në deformim të informacionit që përcjellin ato për publikun e gjerë. Ndoshta roli i AMA-s duhet zgjeruar me ligj, për një verifikim vjetor të pasurive të shoqërive tregtare të licencuara si OSHMA, si dhe të pronarëve përfitues. Vetëm duke u bërë publik ky informacion, atëherë publiku e ka të qartë që pse një media audiovizive bën këtë politikë editoriale apo bën emisione që godasin individë apo grupime të caktuara.
- Në lidhje me reagimet eventuale të AMA-s në mbrojtje të gazetarëve, përmbushja e këtij rekomandimi duhet verifikuar në disa plane, duke marrë ngjarjet kryesore të vitit, pra kur janë kërcënuar apo shantazhuar gazetarët²⁸ (nganjëherë edhe largimet nga puna të gazetarëve janë mënyra represive të punëdhënësit), si dhe pyetur gazetarët që janë viktima të atyre ngjarjeve dhe shoqatat e gazetarëve. Nga një kontroll parësor online nuk rezulton, që AMA të ketë bërë reagime të tilla në mbrojtje të gazetarëve.

iii) Rekomandimet²⁹ e Kuvendit për veprimtarinë e RTSH-së për vitin 2023:

Kuvendi ka miratuar 13 rekomandime për t'u zbatuar nga RTSH-ja gjatë veprimtarisë në vitin 2023, ndër to po veçojmë disa që kanë lidhje me studimin tonë:

“2. Të bëhet transparente veprimtaria e KDRTSH-së në faqen zyrtare online duke u publikuar të gjitha vendimet e marra të shoqëruara edhe me relacionet përkatëse, procesverbalet e mbledhjeve dhe mënyrën e votimit...

10. Në “RTSH Kuvend” të përfshihen edhe përmbajtje informuese dhe shpjeguese të realizuara përmes bisedave, intervistave apo analizave profesionale me ekspertë të fushës për projektligje që janë në proces diskutimi dhe që janë me rëndësi për qytetarin dhe komunitetin, në funksion të konsultimit publik për aktet ligjore.

²⁷ <https://nacionale.com/politike/shqiperi-inceneratori-i-paguan-miliona-medias-se-baton-haxhiut-4582>;

²⁸ <https://dritare.net/ngjarjet-e-dites/gazetarja-e-birn-u-kercenova-per-investigimin-per-inceneratori-i719263>;

²⁹ <https://qbz.gov.al/eli/rezolute/2023/07/06/2222-9/78abeaf9-f630-4d6a-a960-71d5be13dade>;

11. Në kuadër të transparencës, të publikohet në faqen zyrtare struktura organizative dhe organika e RTSH-së, të reflektohen vakancat e krijuara dhe të jetë transparente e gjithë procedura e rekrutimit.

12. KDRTSH-ja të investohet në hartimin e planit strategjik të institucionit për të siguruar qëndrueshmëri dhe vizion në drejtimin e transmetuesit publik...”

- Në lidhje me rekomandimet nr. 1, 11 dhe 12 janë shumë të dobishme për të rritur transparencën në vendimmarrje të Këshillit Drejtues dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH-së, përderisa ka ndryshime të shpeshta të Drejtorit të Përgjithshëm³⁰ të RTSH, çfarë ka sjellë edhe ndikim edhe në institucion, si dhe në vetë punën e gazetarëve.
- Rekomandimi nr. 12 është shumë pozitiv, jo vetëm për punën e RTSH-së në informimin e publikut të gjerë, por edhe **në konsolidimin e lidhjes mes qytetarëve dhe Kuvendit**. Mesa konstatohet nga programi i RTSH KUVEND apo nga emisionet e posaçme, që shfaqen në RTSH nuk ka ende një emision, ku të diskutohen apo shpjegohen projektligjet në shqyrtim, si dhe efektet e pritshme nga zbatimi i tyre. Ndoshta një emision i tillë duhet transmetuar edhe tek Radio Tirana edhe Televizioni Shqiptar.

iv) Disa konstatime shtesë:

Që në fillim të këtij projekti, monitorimi që kemi kryer në faqen online të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ëëë parlament.al kemi konstatuar se:

- Në programin³¹ e punimeve të Kuvendit, për gjatë gjithë këtij vitit mbarteshin pa shpjegim nisma deputetësh, grupe deputetësh apo mbi 20 mijë zgjedhës, që datonin që nga viti 2021 dhe nuk kishin një rubrikë shpjeguese se në cilën fazë të diskutimit parlamentar ishin;
- Edhe tani në përfundim të projektit në programin³² e punimeve, të Kuvendit, për periudhën 16 tetor- 24 nëntor 2023 i gjejmë sërish të njëjtat nisma të pashqyrtuara ende, ndërkohë që nismat ligjore të depozituara nga Këshilli i Ministrave janë shqyrtuar dhe miratuar, si të tilla;
- Kemi kontrolluar si në faqen online të cituar më lart edhe në faqen e vjetër staging.parlament.al, shumë nga nismat e cituara nuk është e mundur të hapen apo të merret më shumë informacion për to;
- Një legjislaturë ushtrohet brenda 4 viteve dhe është e papranueshme, që nismat e këtyre subjekteve si deputet apo zgjedhës të mbeten pa u shqyrtuar mbi një apo dy vite dhe pa asnjë shpjegim, që pse mbeten të tilla, pa u shqyrtuar. Ndërkohë, që ndër këto nisma do të veçonim të tilla, që ka sensibilitet të lartë nga njerëzit, si:

³⁰ <https://www.oranews.tv/vendi/birn-ankesa-per-shkarkim-te-padrejte-ne-radio-televizionin-publik-shqiptar-i1102347>;

³¹ <https://webapi.parlament.al/Files/202304181119047926Programi%20i%20punimeve%2010%20Prill%202023%20-%2019%20Maj%202023.docx%20i%20ndryshuar.pdf>;

³² <https://webapi.parlament.al/Files/202310121401023328Programi%20i%20pun%C3%ABs%2016%20tetor%20%E2%80%93%20n%C3%ABntor%202023.pdf>

1. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, i propozuar nga deputetja Ina Zhupa, me datën 11. 5. 2022,
 2. Projektligji “Për Referendumet”, i propozuar nga deputeti Dashamir Shehi, me datën 2. 6. 2022,
 3. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29. 12. 2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë“, i ndryshuar, i propozuar nga 22.699 zgjedhës,
 4. Projektligji “Për caktimin e minimumit jetik”, i propozuar nga 20 mijë zgjedhës, etj.
- Pra mungon transparenca për përmbajtjen e këtyre nismave, ndryshe veprohet në faqen online të Kuvendit për nismat e Këshillit të Ministrave, për të cilat hidhet online si përmbajtja e projektligjit, relacioni shoqërues, RIA, raporti i konsultimit publik, si dhe fazat e shqyrtimit në komisione, në seancë plenare, etj, për nismat nga subjektet e tjera gjendja është si më lartpërshkruar;
 - Mungesa e transparencës për këto nisma dhe zvarritja e pashpjegueshme në shqyrtimin e tyre e zbeh rolin e deputetit apo të 20 mijë zgjedhësve në procesin legjislativ dhe i dekurajon edhe të tjerët për të ndërmarrë nisma legjislative, që synojnë zgjidhjen e çështjeve më të mprehta të shoqërisë.

VIII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione:

- Legjislacioni në fushën e lirisë së shprehjes, së drejtës për informim dhe të drejtave të gazetarëve duket i plotë, por konstatohet herë pas here moszbatim i tij, që çon në cënim të këtyre lirive dhe të të drejtave;
-
- Gazetarët janë të censuruar nga pronarët e mediave, pasi këto të fundit kanë lidhje të ngushta dhe okulte me qeverinë, pushtetin ekonomik apo qarqe të tjera të interesave të krimit;
- Për shkak të këtij censurimi besimi i publikut tek mediat është i lëkundur;
- Të drejtat e gazetarëve në fushën e punësimit vijojnë të jenë të pazbatuara, ende ka gazetarë që punojnë pa kontrata pune, ose me kontrata me peëriudha prove për t'i mbajtur nën presion, ose janë të paguar ligjërisht me paga minimale dhe përfitojnë shpërblime shtesë me pagesa cash;

Rekomandime:

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të ndërmarrë nisma të rishikimit të legjislacionit në fuqi, për t'i paraprirë evoluimit të profesionit të gazetarit, duke përcaktuar ligjërisht

statusin e gazetarit, incentiva për vetëorganizimin e këtij profesioni të lirë, si dhe për mbështetjen nga Shteti të ;

- shoqatave dhe të sindikatave të gazetarëve;
- Të realizohet transparencë e plotë e strukturës së pronësisë, përfshirë pronarët përfitues të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA);
- Të realizohet transparencë e plotë e kontratave mes OSHMA-ve, pronarëve përfitues apo gazetarëve të ndryshëm nga njëra anë, me institucionet shtetërore apo personat juridikë publikë nga ana tjetër;
- Faqet online të institucioneve shtetërore apo të personave juridikë publikë të pasurohen me informacione të rëndësishme, varësisht dinamikës së veprimtarisë së institucionit, në konsultim paraprak, vjetor, me grupin e të interesuarve/ subjekteve, që kane lidhje me fushën;
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të bëjë transparente çdo nismë ligjore, që është e depozituar dhe përfshirë në programin e punës të miratuar;
- Nismat ligjore të depozituara në Kuvend të shqyrtohen dhe t'i nënshtrohen vendimmarrjes brenda vitit të depozitimit të tyre.

REFERENCAT

- Balkan Investigative Reporting Network (BIRN). (2020). Internet Governance. Marrë nga: <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2020/08/Internet-Governance-1-1.pdf>
- Komisioni European. (2023). Shqipëria 2023 (SWD(2023) 690 final). Faqja 31. Marrë nga: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf
- Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Neni 102. Marrë nga: <https://www.parlament.al/lajme/%206c285006-9d79-41b7-85d6-e629dbb0c42f5d6-e629dbb0c42f>
- Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Neni 100. Marrë nga: <https://www.parlament.al/lajme/%206c285006-9d79-41b7-85d6-e629dbb0c42f>
- Reporters Without Borders (RSF). (Për Shqipërinë). Marrë nga: <https://rsf.org/en/country/albania>
- Freedom House. (Për Shqipërinë). Marrë nga: <https://freedomhouse.org/country/albania>
- OSCE Presence in Albania. (Media Freedom and Development). Marrë nga: <https://www.osce.org/presence-in-albania/media-freedom-and-development>
- Barometri Kombëtar për Lirinë e Medias në Shqipëri (Tetor 2022). Marrë nga: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Medias-ne-Shqiperi_Tetor-2022-KShH.pdf
- Instituti për Zhvillim dhe Promovim (IDP). (Raporte Vjetore). Marrë nga: <https://www.idp.al/raporte-vjetore/>
- Instituti për Zhvillim dhe Promovim (IDP). (Rezolutat e Kuvendit). Marrë nga: <https://www.idp.al/rezolutat-e-kuvendit/>
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998.
- Ligji nr. 78/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Fletorja Zyrtare nr. 152, datë 20.10.2023. Marrë nga: <https://www.idp.al/>
- Programi i Transparencës, Tatime. Marrë nga: <https://www.tatime.gov.al/c/545/programi-i-transparences>
- Marrë nga: <https://www.tatime.gov.al/c/545/programi-i-transparences>
- Programi i Transparencës, Dogana. Marrë nga: <https://dogana.gov.al/programi-i-transparences.php>
- Programi i Transparencës, Qendra e Biznesit në Zyrën Kombëtare të Regjistrimit. Marrë nga: <https://qbz.gov.al/eli/rezolute/2023/07/06/2222-8/aa7bd3d3-d091-4b2f-b441-a7c25ca61063>
- Lajme Parlamenti. (Mbi Programin e Punimeve). Marrë nga: <https://www.parlament.al/lajme/%206c285006-9d79-41b7-85d6-e629dbb0c42f>
- Nacionale.com. (Shqipëri: Inceneratorët i Paguan Miliona Medias së Baton Haxhiut). Marrë nga: <https://nacionale.com/politike/shqiperi-inceneratoret-i-paguan-miliona-medias-se-baton-haxhiut-4582>
- Dritare.net. (Gazetarja e BIRN u Kërcenova për Investigimin për Inceneratorët). Marrë nga: <https://dritare.net/ngjarjet-e-dites/gazetarja-e-birn-u-kercenova-per-investigimin-per-inceneratoret-i719263>

Aneks 1: Lista e institucioneve të kontaktuar

- *Autoriteti Mediave Audiovizive, Kryetarja zj. Armela Krasniqi, info@ama.gov.al*
- *RTSH Drejtori i përgjithshëm z. Alfred Peza, info@rtsh.al*
- *ATSH, Drejtor i Përgjithshëm znj. Almarina Gegvataj, info@ata.gov.al*
- *Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale, Komisioneri z. Besnik Dervishi, info@idp.al*
- *Avokati i Popullit zj. Erinda Ballanca, erinda.ballanca@avokatipopullit.gov.al*
- *Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë, z. Aleksandër Cipa aleksandercipa@gmail.com*
- *Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, unioniigazetareve@gmail.com*
- *Open data znj. Aranita Brahaj, aranita.brahaj.@ais.al*
- *European Center for Press and Media Freedom- Znj. Flutura Kusari, flutura.kusari@ecpmf.eu*
- *Instituti i Medias, z. Remzi Lani, Drejtor, rlani@institutemedia.org*
- *BIRN Albania, Gjergj Erebara*
- *Zj. Valbona Sulçe, gazetare*
- *Z. Zylyftar Bregu, Lektor në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës*